

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës–Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.A. nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorisë Themelore–Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore–DKR në Prishtinë, PKR.nr.191/2017, të dt. 14.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform dispozitës së nenit 390 të KPPK, më datë 04.10.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.191/2017, të dt. 14.05.2018, vërtetohet.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e Themelore-DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.191/2017, të dt. 14.05.2018, të akuzuarin S.A., bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par.3 të KPPK, e ka liruar nga akuza për veprën penale vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së, me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar me akuzën e prokurorisë.

Për shpenzimet e procedurës penale ka vendosur që të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së Ligjit Penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari të shpallet fajtor sipas propozimit në aktakuzë ose të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës, së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën nuk janë njoftuar fare, palët pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktgjykim, ku është shqiptuar dënimi me burgim prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.388/2018, të datës 06.09.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet, ndërsa, çështja të kthehet në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar, në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore – DKR në Prishtinë, në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat qëndrojnë në faktin se i njëjti nuk përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare gjegjësisht ato që janë dhënë, janë të pa qarta dhe në masë të konsiderueshme në kundërtënie, sidomos përkitazi me faktet vendimtare, e po ashtu të njëjtat arsye janë në kundërshtim edhe me përmbajtjen e shkresave–provave të deponuara në këtë çështje penalo-juridike. Kështu, gjithë herë sipas pretendimeve ankimore, theksohet se gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye të plota përkitazi me këtë çështje penalo-juridike, sidomos përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, duke mos marrë kështu fare parasysh deklaratat e të dëmtuarave, gjegjësisht ka marrë parasysh vetëm deklaratat e të dëmtuarave të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pra, jo edhe deklaratave të dëmtuarave të dhëna në fazat e mëhershme në këtë çështje penale – juridike. Gjithherë, sipas pretendimeve ankimore, pretendohet se edhe pse gjykata e shkallës së parë, në arsyetim thirret në bazë të dispozitave të nenit 361 të KPPK-së, e njëjta faktikisht, pikërisht dispozitat në fjalë nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë, ngase, sipas par. 2 të dispozitës së nenit 361 të KPPK-së, parashihet shprehimisht se gjykata detyrohet që çdo provë të proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor ta vlerësojë me ndërgjegjeje të plotë, që do të thotë se duhet të merren parasysh edhe provat tjera, si në rastin konkret edhe deklaratat e të dëmtuarave të dhëna në fazat e mëhershme të procedurës në këtë çështje penale-juridike dhe vetëm, atëherë, gjykata e shkallës së parë, ishte dashur t'i merr parasysh të gjitha deklaratat e dhëna në këtë çështje penale juridike, pastaj, të jap vlerësimin e saj, e duke aprovuar konkludimet e saja, përkitazi me kundërtëniën në mes këtyre deklaratave, e jo sikur që ka vepruar në rastin konkret edhe përkundër prezencës së deklaratave të dëshmitarëve në fjalë, por edhe provave tjera materiale në shkresat e lëndës, pra, në kundërshtim me të gjitha këto prova, të akuzuarin e liron nga akuza, për çka konstaton se gjykata e shkallës së parë, me vetë faktin se të akuzuarin e liron nga akuza ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, por as që ka shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e që kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.12 të KPPK-së, ngase, aktgjykimi i ankimuar duke përfshirë edhe arsyetimin, është i qartë dhe konkret, po ashtu përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante në këtë çështje penale-juridike dhe gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare dhe atë qasja ndaj fakteve vendimtare përveç që ka qenë e drejtë, objektive dhe e ligjshme, po ashtu ka mbështetje edhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe atë përveç deklaratës së vetë të akuzuarit, ka marrë parasysh edhe deklaratat e të dëmtuarave si dhe provat materiale në shkresat e lëndës, prandaj, nuk qëndron pretendimi ankimor se të njëjtat nuk kanë mbështetje në provat e proceduara në seancën gjyqësore. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e saj e ka bazuar së pari në mbrojtjen e të akuzuarit, i cili nuk i mohon faktet dhe rrethanat se i akuzuari me të dëmtuarat ka bashkëjetuar, ku me disa nga ato kanë edhe fëmijë të përbashkët, se kanë punuar dhe se parat që i kanë fituar i kanë shpenzuar bashkërisht për shpenzime familjare, ka ndodhur që pagat nuk iu ka dhënë të dëmtuarave, por të njëjtat janë kompensuar në shpenzimet e përbashkëta familjare, pastaj, se i akuzuari është kujdesur për fëmijët, ku disa prej tyre – pra, të dëmtuarat fëmijët i kanë pasur edhe nga martesat e mëparshme, pastaj, se i akuzuari iu ka ndihmuar edhe në dërgimin e fëmijëve nëpër shkolla, ndërsa, sa i përket kushteve të përgjithshme të jetesës edhe pse kanë qenë të rënda dhe të varfëra, kanë qenë kushte në të cilat kanë jetuar të gjithë anëtarët e familjes njësoj. Po ashtu, përveç nga mbrojtja e të akuzuarit edhe nga deklaratat e të dëmtuarave, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se të njëjtat nuk kanë qenë të mbyllura as të detyruara që të bashkëjetojnë me të akuzuarin, se të njëjtat kanë mundur të largohen kur kanë dashur, gjë që edhe e ka bërë më vonë e dëmtuara B.T., pastaj, se nuk kanë qenë të detyruar të punojnë, por të njëjtat kanë punuar me dëshirën e tyre në vende të ndryshme, e kjo ka ndodhur që kanë punuar edhe në kafenenë e të akuzuarit, i cili për këtë i ka paguar në shumë prej 10 €, për çdo ditë dhe se edhe kur ka ndodhur që nuk i ka paguar atëherë, është bërë kompensimi në shpenzime të përbashkëta familjare. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim ka dhënë vlerësimin e saj edhe për deklaratat e të dëmtuarave të dhëna në fazat e mëhershme, ku ka marrë parasysh edhe pjesën e deklaratave, ku të njëjtat deklarojnë se i akuzuari ka ndodhur që ka përdorë edhe dhunë ndaj tyre, por, këto raste kanë qenë kryesisht momente kur ka pasur mosmarrëveshje në mes tyre si dhe grindje familjare, e që këto raste mund të jenë objekt i ndonjë veprë tjetër penale nga kapitujt e tjerë, por kurrsesi nuk kanë të bëjnë me veprën penale vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së, për të cilën edhe është akuzuar nga prokuroria i akuzuari S.A., prandaj, edhe në këtë aspekt nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nuk janë dhënë arsye edhe për provat kundërthënëse, gjegjësisht, deklaratat e të dëmtuarave të dhëna në fazat e mëhershme në këtë çështje penale-juridike, prandaj, nuk qëndron pretendimi ankimor se konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, nuk kanë mbështetje në provat dhe shkresat tjera në lëndë. Prandaj, konstatimi se me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarr ndonjë veprim inkriminues në drejtim të veprës penale vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së, është i ligjshëm dhe i drejtë, për çka më në detaje përkitazi me këtë do të

bëhet fjalë dhe gjatë elaborimit të pretendimeve ankimore përkitazi me gjendjen faktike në këtë çështje penale-juridike.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljet e ligjit penale dhe gjetjet e gjykatës.

Me ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, konstatohet se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike, për çka edhe ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, ku të akuzuarin e ka liruar nga akuza për veprën penale vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së, ngase, në rastin konkret në këtë çështje penale-juridike nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë deklaratën e të dëmtuarave, ngase, nuk ka marrë parasysh deklaratat e të dëmtuarave të dhëna në fazat e mëhershme por vetëm atë të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, për çka, pretendon se sikur të merreshin parasysh deklaratat e të dëmtuarave-dëshmitareve të dhëna në fazën e mëhershme të procedurës në këtë çështje penale-juridike, atëherë do të vërtetohej gjendja faktike e përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktakuzës, por edhe përkundër deklaratave në fjalë, gjykata e shkallës së parë, e ka liruar të akuzuarin nga akuza për veprën penale që i vihet në barrë, duke e shkelur njëkohësisht edhe Ligjin Penal, kuptohet në favor të akuzuarit S.A..

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cekura si më lartë, nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, provat e proceduara i ka vlerësuar me përputhje me dispozitat e nenit 361 të KPPK-së, kështu që drejtë i ka vlerësuar dhe analizuar faktet vendimtare, përkitazi me këtë çështje penalo–juridike dhe në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës edhe e ka liruar të akuzuarin nga akuza, për veprën penale vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së.

Në rastin konkret me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari S.A. përveç me të dëmtuarën – bashkëshorten e tij A.A., me të cilën ka pasur katër fëmijë, në bashkësi jashtëmartesore ka jetuar edhe me të dëmtuarën F.K.- T , pastaj, me të dëmtuarat. T. C., B.T. dhe A.A., ku fëmijë ka pasur përveç me bashkëshortes me kurorë – A.A. edhe atë katër fëmijë, edhe me bashkëshorten tjetër në bashkësi jashtëmartesore, F.K., mirëpo, gjithashtu, fëmijët e të dëmtuarës B.T., të cilët i ka pasur nga martesat e mëhershme, pra, të gjithë këta në bashkësi familjare kanë jetuar së bashku me të akuzuarin në një familje, pastaj, se herë pas here, të njëjtat – pra, të dëmtuarat me dëshirën e tyre kanë punuar përveç në kafenet tjera, po ashtu, kanë punuar edhe në kafenen e të akuzuarit, për çka janë paguar në shumë prej 10 €, në ditë, mirëpo, edhe kur ka ndodhur që nuk i kanë marrë paratë të njëjtat i kanë llogaritur në shpenzime të përbashkëta familjare, se të njëjtat përveç që kanë punuar si kamariere, valltare por edhe pastruese, në kafenen e të akuzuarit kanë qenë edhe menaxhere, sikur që ka ndodhur me të dëmtuarën T.C., por edhe B.T.. Po ashtu, nuk janë kontestuese faktet dhe rrethana se përveç me të dëmtuarën A.A. të cilën e ka bashkëshorte, një kohë të gjatë ka bashkëjetuar edhe me të dëmtuarën F.K. - T., dhe atë diku prej gjashtë vjetësh, në bashkësi familjare ka jetuar edhe me tri të dëmtuarat tjera, pra, T.C., B.T. dhe A.A., të gjitha këto, kuptohet pasi i ka njoftuar nëpër kafenet të cilat i akuzuari i ka vizituar si klient i rregullt, ndërsa, të dëmtuarat kanë punuar nëpër kafene si kamariere ose si edhe valltare, e pasi që është njoftuar me të njëjtat, pasi kanë filluar edhe raporte dashurie në mes veti, pastaj, me pajtimin e tyre kanë shkuar që të jetojnë në shtëpinë e të akuzuarit, kuptohet ku kanë kaluar edhe në raporte intime, e me disa nga to

kanë lindur edhe fëmijë të përbashkët, ndërsa, disa nga ato në këtë bashkësi familjare i kanë sjellë edhe fëmijët të cilët i kanë pasur nga martesat e mëparshme, e që kanë jetuar të gjitha bashkërisht, pra, edhe me fëmijët e të akuzuarit në një bashkësi familjare, në një shtëpi të vetme, pa kushte elementare të jetës, pra, në kushte të rënda - varfri të thellë ekonomike, pra, në kushte të njëjta për të gjithë njësojë që kanë jetuar në një shtëpi me të akuzuarin. Gjithashtu, nuk janë kontestuese faktet dhe rrethanat se shumica prej të dëmtuarave kanë punuar në vende të ndryshme të punës, dhe atë si kamariere, valltare por edhe pastruese, kurse disa nga të dëmtuarat kanë ndodhur që kanë punuar edhe në kafenen e të akuzuarit si e dëmtuara B.T. dhe T.C., për çka, të gjitha janë paguar por nëse kanë ndodhur që të mos i marrin parat nga i akuzuari, në bazë të marrëveshjes, shumat në fjalë i kanë kompensuar në shpenzime të përbashkëta familjare, shpenzime këto që i akuzuari i ka bërë përveç ushqimit dhe veshmbathjen e të dëmtuarave edhe për fëmijët e tyre që i kanë sjellë nga martesat e mëparshme, kuptohet, pastaj, për fëmijët që i akuzuari i ka pasur nga bashkësia martesore, pra, katër fëmijët, që do të thotë se të gjithë kanë jetuar në një shtëpi e në kushte të njëjta të jetesës, mirëpo, asnjëherë nga të dëmtuarat nuk ka qenë e detyruar që të punojë.

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese, se i akuzuari S.A., ai ka mbajtur të dëmtuarat me detyrim dhe atë në kushte skllavërie e duke i detyruar që të punojnë dhe që frytet e punës së tyre t'i shfrytëzojë i akuzuari, pastaj, që të njëjtave t'u ketë mohuar lirinë, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, përveç mbrojtjes së të akuzuarit i cili në mënyrë kategorike ka mohuar faktet dhe rrethanat në fjalë ka marrë parasysht edhe deklaratën e të dëmtuarës T.C., e cila me deklaratën e saj ka vërtetuar faktet dhe rrethanat se pasi është njoftuar më parë me të akuzuarin në lokalin ku ka qenë duke punuar si kamariere, ku i akuzuari ka ardhur shpesh për t'u argëtuar, njoftohen me të akuzuarin dhe fillojnë edhe të argëtohen, e kështu kanë kaluar edhe në raporte intime, pastaj, janë pajtuar që e dëmtuara të shkojë në shtëpinë e të akuzuarit që të jetojnë së bashku, ku aty ka gjetur edhe bashkëshorten e tij A. me katër fëmijë, pastaj, bashkëshorten tjetër në bashkësi jashtëmartesore F.K.-T., e cila po ashtu, me të akuzuarin kishte lindur edhe një fëmijë. Sipas të dëmtuarës në fjalë, me të akuzuarin kishin kaluar shumë kohë dhe pasi më parë ishin njoftuar në lokalin e R..., ku ka qenë duke punuar si kamariere dhe pasi e dëmtuara e njofton pronarin e lokalit për raportet e saj me të akuzuarin dhe pasi më parë e njëjta shkon të jetojë në shtëpinë të akuzuarit, kalon pastaj të punojë si kamariere në lokalin e të akuzuarit, ku për këtë është paguar në shumë prej 10 €, për një ditë, ku në ndërkohë kishte lindur edhe një fëmijë dhe se gjatë kësaj kohe, sipas deklaratës së dëshmitares, ka ndodhur që i akuzuari është sjellë në mënyrë të dhunshme me të dëmtuarin dhe atë kryesisht për shkak të problemeve të ndryshme familjare, ndërsa, sa i përket pagesës prej 10 €, në emër të punës, ka ndodhur që i dëmtuari nuk e ka paguar, mirëpo të njëjtat pastaj me marrëveshje janë zbatuar në shpenzime të përbashkëta familjare dhe përfundimisht për shkak të problemeve të përditshme familjare, grindjeve në mes tyre, por edhe dhunës që ka përdorur i akuzuari, e dëmtuara është ndarë nga i akuzuari dhe atë gjatë kohës kur i akuzuari ka qenë në pushime me grua tjetër, e dëmtuara pastaj e ka lëshuar shtëpinë dhe ka shkuar të punojë në një vend tjetër në Ferizaj, ku në fillim ka qëndruar në një strehimore pastaj, ka kaluar në një shtëpi tjetër për banim. Pastaj, po, për faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysht edhe deklaratën e të dëmtuarës – dëshmitares A.A., e cila ka deklaruar se pasi është njoftuar me të akuzuarin në një lokal ka vendosur të bashkëjetojë me të njëjtin në një shtëpi, ku në shtëpi ka gjetur bashkëshorten e të akuzuarit A.A. bashkëshorten tjetër në bashkësi jashtëmartesore F.K., ndërsa, në atë kohë e dëmtuara tjetër B.T., nuk ka qenë në shtëpi, mirëpo, në ndërkohë ka ardhur të jetojë së bashku në një familje edhe B.T. me djalin e sajë, dhe atë pasi më parë, e njëjta ishte larguar nga burri i saj dhe kishte mbetur në rrugë,

dhe pasi që i kërkon të akuzuarit që të shkojë ta marrë dhe ta pranojë në shtëpi, i akuzuari ka shkuar e ka marrë dhe e ka sjellë në shtëpinë e njëjtë, ku kanë jetuar të gjithë bashkërisht, pra, bashkëshortja Afërdita me katër fëmijët, bashkëshortja tjetër në bashkësi jashtëmartesore F.K., B.T. me fëmijët e saj dhe e dëmtuara A.A.. Mirëpo, në këtë moment, gjithëherë sipas deklaratës së dëshmitares A.A., kur është kthyer në shtëpinë e të akuzuarit e dëmtuara B.T., kanë filluar problemet, dhe atë krejt për shkak të xhelozisë së T.C., e cila nuk është pajtuar asesi, që i akuzuari të largohet nga e dëmtuara T.C. dhe të fillojë sërish marrëdhëniet me të dëmtuarën B.T., për çka, ka ardhur edhe deri te paraburgimi i të akuzuarit, ngase, me të dëgjuar për kthimin e B.T. nga e dëmtuara T.C., e njëjta i ka kërkuar të akuzuarit që mos ta harrojë T.C. vetëm për shkak të B.T. dhe se lokalën, gjegjësisht kafenen që ishte e regjistruar në emër të T.C., mos ta regjistrojë në emër të B.T.. Faktet dhe rrethanat në fjalë, i ka vërtetuar edhe e dëmtuara B.T., e cila deklaron se pasi njoftohet me të akuzuarin në kafenen ku ka qenë duke punuar fillojnë me të njëjtin edhe raportet intime, pastaj, vendosin që të bashkëjetojnë, kuptohet pasi edhe martohen dhe se para se të shkojë në shtëpi me jetuar në bashkësi familjare me të akuzuarin, e njëjta e ka ditur se i akuzuari ka edhe tri gra tjera në shtëpi me të cilat, pra, ka jetuar së bashku në një shtëpi, gjatë kohës së martesës, pastaj ka kaluar të punojë në lokalën e të akuzuarit – kafenen dhe atë si kamarierë, për çka edhe është paguar në shumë prej 10 € në ditë, para këto të cilat së bashku me paratë tjera të akuzuarit, i kanë paguar bashkërisht shpenzimet e përditshme familjare. Në ndërkohë për shkak të mospajtimeve e dëmtuara është ndarë me të akuzuarin dhe ka shkuar tek burri i saj i mëparshëm, mirëpo, pasi që ka pasur probleme të përditshme me të njëjtin, sërish ka ikur nga burri i saj i mëparshëm dhe me dëshirën e saj, është kthyer sërish tek i akuzuari me fëmijën e saj nga martesja e mëhershme, i cili – pra, i akuzuari e ka pranuar sërish dhe kanë filluar të jetojnë në një bashkësi familjare, ku gjatë kësaj kohe me dëshirën e saj ka punuar dhe se e njëjta nuk ka qenë e mbyllur asnjëherë por as nuk ka qenë e detyruar që të shkojë në punë, pra, ka punuar çka ka dashur vetë personalisht, por, pastaj për shkak të problemeve të përditshme familjare, grindjeve por edhe përdorimit të dhunës nga i akuzuari herë pas here e dëmtuara ka vendosur që të ndahet, për çka, pastaj edhe së bashku me fëmijën e saj është larguar nga i akuzuari.

Prandaj, në bazë të një gjendje të tillë faktike të vërtetuar si më lartë, rezulton se i akuzuari S.A., nuk i ka detyruar të dëmtuarat që të jetojnë së bashku në një shtëpi, e as të punojnë pa dëshirën e tyre, ndërsa, nëse kanë punuar parat nuk ua ka marrë i akuzuari, duke i detyruar por me të njëjtat, herë pas here kur nuk ua ka dhënë parat, me marrëveshje kanë bërë kompensimin e shpenzimeve të përbashkëta familjare, shpenzime këto që janë bërë përveç përmbajtjen e bashkëshortes me fëmijët e vetë edhe e përmbajtjen e vetë të dëmtuarave por edhe fëmijët që i kanë pasur nga martesja e mëparshme, që do të thotë se të dëmtuarat pastaj nuk kanë qenë të mbyllura por kanë dalë sa herë që kanë dashur, ndërsa, sa i përket kushteve të jetesës të njëjtat kanë qenë për të gjithë njësojë, pra, si për të akuzuarin, familjen e tij edhe për të dëmtuarat, prandaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konkluduar se në veprimet e të akuzuarit, nuk përmbushen elementet e veprës penale vendoja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së, vlerësim ky i drejtë dhe i logjikshëm që do të thotë se drejtë është aplikuar edhe Ligji Penal, dhe nuk ka shkelje të Ligjit Penal, në favor të akuzuarit, sikur që pretendohet në ankesë.

Prandaj, duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, ku i akuzuari pasi më parë njoftohet me të dëmtuarat në kafene të ndryshme dhe me të njëjtat më pas fillon edhe me raporte intime, ku pastaj vendosin që të bashkëjetojnë në shtëpinë e përbashkët familjare, ku jetonte dhe bashkëshortja me katër fëmijët, pastaj, bashkëshortja

tjetër në bashkësi jashtëmartesore, në kushte të njëjta për të gjithë, ku disa nga të dëmtuarat kanë sjellë fëmijët edhe nga martesat e mëparshme, se disa nga të dëmtuarat kanë punuar përveç në vende tjera edhe në kafenen e të akuzuarit dhe përkitazi me këtë janë paguar dhe të gjitha të ardhurat i kanë shpenzuar bashkërisht për shpenzime familjare dhe, edhe kur ka ndodhur që nuk i ka paguar, atëherë shumat në fjalë i kanë kompensuar në emër të shpenzimeve të përbashkëta familjare, se asnjëra nga të dëmtuarat nuk kanë qenë të mbyllura, se nuk kanë qenë të detyruara të punojnë dhe nëse kanë punuar edhe janë paguar se të gjithë kanë jetuar në kushte të njëjta, pra, në varfri të thellë ekonomike, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar nga neni 169 par. 1 të KPRK-së, ngase, me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka detyruar të dëmtuarat të bashkëjetojnë apo edhe të punojnë për të njëjtin – pra, të akuzuarin ose i njëjti t’iu ketë cunguar lirinë si dhe t’i ketë detyruar që të jetojnë në kushte të rënda ekonomike, ndryshe, nga ato që ka jetuar personalisht i akuzuari me familjen e tij, prandaj, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore, se i akuzuari është dashur të shpallet fajtor për këtë veprë penale, qartazi janë të pa bazuara e pa mbështetje në prova, apo në shkresa tjera të lëndës.

Nga çka u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.410/2018, të dt. 04.10.2018**

**Procesmbajtësi,**  
**Sadik Kryeziu**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**1.Xhevdet Abazi**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Abdullah Ahmeti**

**2.Fillim Skoro**